

V E N D I M
Nr.605, datë 31.12.1993

PËR RITJEN E PENSIONEVE DHE TË TË ARDHURAVE NGA PAPUNËSIA

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Të rriten në masën 15 për qind të gjitha llojet e pensioneve të përfituara nga ligji nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës së Shqipërisë” dhe nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Të rriten në masën 15 për qind të ardhurat nga papunësia, të përfituara nga ligji nr.7521, datë 30.10.1991 “Për përkrahjen sociale për personat që dalin nga zbatimi i reformës ekonomike”, si dhe nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore shtetërore në Republikën e Shqipërisë”.

Shtesën prej 15 për qind e përfitojnë edhe personat që u ka lindur e drejta për pension dhe të ardhura nga papunësia para datës 31.12.1993.

Nuk përfitojnë rritje pensioni personat që sipas nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, nuk plotësojnë kushtet e ligjit nr.4171, datë 13.9.1966.

2. Pensionit dhe të ardhurave nga papunësia, të rillogaritura sipas pikës 1 të këtij vendimi , u shtohet vlefë prej 494 lekësh e kompensimeve të përfituara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.30, datë 24.7.1992 “Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë”, dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.274, datë 12.6.1993 “Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimit të bukës”.

Pensionit për vjetërsi shërbimi (sipas nenit 20/a dhe 40 të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, i ndryshuar) dhe pensionit të invaliditetit pas rillogaritjes nuk i shtohet vlefë e kompensimeve prej 494 lekësh, në qoftë se personi që e gëzon atë është në marrëdhënie pune ose merr të ardhura nga papunësia.

3. Pensionit të përfitur nga ligji nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore”, i shtohet vetëm vlefë e kompensimeve prej 494 lekësh, në qoftë se personi që e gëzon atë është me banim të përhershëm në qytet ose qendra të banuara (vërtetuar nga organet e pushtetit lokal).

4. Për zbatimin e këtij vendimi

- Ministria e Punës, Emigracionit dhe e Përkrahjes Sociale, si dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ngarkohen të nxjerrin udhëzime përkatëse.

- Organikës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen 200 persona me fond page 9.2 milionë lekë.

5. Efektet financiare të parashikohen në projektbuxhetin e vitit 1994.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi